



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 85

Tiranë – E mërkurë, 12 qershor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86, datë 11.6.2019	6267
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019	6269



VENDIM
Nr. 86, datë 11.6.2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 23, DATË 7.2.2019,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,
“MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KRITERET DHE PROCEDURËN
E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM
TË GJYQTARIT”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89, 97 dhe 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

Në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” të miratuar me vendimin nr. 23, datë 7.2.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të bëhen shtesat dhe ndryshime si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2 shtohet shkronja “ë” me përmbajtjen si më poshtë:

“ë) “Gjyqtari me përvojën më të pakët në atë gjykatë” nënkupton gjyqtarin e gjykatës nga ku do të bëhet transferimi, i cili ka përvojën më të pakët si gjyqtar në të njëjtën shkallë gjykimi”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e nenit pas fjalës “Parimet” shtohen fjalët “dhe kriteret”.

2. Në pikën 4 pas fjalëve “Transferimi i përkohshëm” shtohet fjala “si rregull”.

3. Po në pikën 4 pas fjalisë së parë shtohet fjalia “Përjashtimisht, nëse transferimi i përkohshëm sipas këtij rregulli do të cenonte funksionalitetin e gjykatave me ngarkese me të ulët, transferimi mund të bëhet nga gjyqtarët e

gjykatave të tjera, por në çdo rast duke respektuar parimin sipas pikës 3, të këtij neni”.

4. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia “Pavarësisht kësaj, me pëlqimin e gjyqtarit, transferimi i përkohshëm mund të përsëritet, sipas procedurës së përcaktuar në kreun II të kësaj rregulloreje”.

5. Në pikën 8, pas fjalëve “periudhës së transferimit” shtohet fjala “të përkohshëm”.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, me kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 dhe 1.2 me përmbajtjen si më poshtë:

“1.1 Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas formularit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

1.2 Në rastin e një gjykatë në nevojë, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një gjyqtar, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm duke ftuar, fillimisht, për të dhënë pëlqimin, gjyqtarin që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme. Në një rast të tillë, ky gjyqtar mund të transferohet përsëri përkohësisht në gjykatën në nevojë në rast se jep pëlqimin”.

3. Në pikën 3 fjalët “për trajtimin e kërkesës për transferim” zëvendësohet me fjalët “të procedurës së transferimit të përkohshëm”.



Neni 4

Neni 6 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Në rastin e shpalljes së një pozicioni të lirë të përkohshëm në një gjykatë, në të cilën ka gjyqtarë të transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij gjyqtari.

2. Nëse gjyqtari i transferuar përkohësisht me pëlqim në një gjykatë që është sërish në nevojë, nuk jep pëlqim, si dhe në çdo rast tjetër të shpalljes së një pozicioni të lirë në një gjykatë në nevojë, dhënia e pëlqimit iu kërkohet të gjithë gjyqtarëve që përmbushin kriteret për pozicionin e lirë të përkohshëm të shpallur.

3. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban edhe kriteret e transferimit të përkohshëm”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 2 fjalët “të përcaktuara në kërkesë” hiqen.

Neni 6

Në nenin 8 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “plotësimi të kriterëve” shtohet fjala “të transferimit”.

2. Në pikën 3, pas fjalëve “për transferim të përkohshëm” shtohet fjalia “bazuar në ndikimin e transferimit, në ngarkesën e gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin, si dhe në përvojën profesionale të tij në raport me fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”.

Neni 7

Në nenin 10 bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 1 fjalët “dhe nis procedurat e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari pa pëlqim” zëvendësohen me fjalët “i cili vendos për nisjen e procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim të një gjyqtari”.

Neni 8

Në nenin 11 bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 1, shkronja “c” hiqen fjalët “në atë gjykatë”.

Neni 9

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “shqyrton informacionin e mbledhur sipas nenit 6”, zëvendësohen me fjalët “kërkon nga kryetarët e gjykatave informacionin e nevojshëm”.

2. Pika 2 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

“2. Pas përcaktimit të gjykatës me ngarkesën më të ulët, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon në atë gjykatë gjyqtarin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t’u transferuar përkohësisht. Në rastin e disa gjykatave me ngarkesë më të ulët sipas kësaj pike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon për secilën nga këto gjykata gjyqtarin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t’u transferuar përkohësisht”.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Qoku

**URDHËR**

Nr. 200, datë 16.5.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KUSHTET, KRITERET DHE
PROGRAMET PËR PËRGATITJEN
TEORIKO-PRAKTIKE TË
KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E
DËSHMISË SË AFTËSISË
PROFESIONALE PËR PËRDORUESIT E
MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME
NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE
DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË
MAKINERIVE TË NDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 3/b, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 4.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë”, të ndryshuar, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 109, datë 5.8.2013, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE

**PËR KUSHTET, KRITERET DHE
PROGRAMET PËR PËRGATITJEN
TEORIKO-PRAKTIKE TË
KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E
DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE
PËR PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË
RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE
TOKE, SI DHE DISIPLINIMI I
PËRDORIMIT TË TYRE**

KREU I

**QËLLIMI, OBJEKTI I RREGULLORES DHE
FUSHA E VEPRIMIT**

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen mbi baza ligjore të aktivitetit, administrimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre në zbatim të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet.

Neni 2

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe rregullat për:

1. përgatitjen teorike dhe praktike të shtetasve që kërkojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale DAP, të përdoruesit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke;

2. vendosjen e rregullave të administrimit, organizimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke nga subjekte ose persona që i kanë në posedim.

Neni 3

Përkufizime për efekt të kësaj rregulloreje:

a) “Dëshmia e Aftësisë Profesionale” (DAP), dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike mbi përcaktimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet në punë dhe njohurive teknike dhe profesionale për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke;

b) “Subjekt juridik”, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje mund të jetë çdo subjekt



ndërtues, bonifikues ose autoshkollë, e pajisur me licence të veçantë për ushtrimin e veprimtarisë autoshkollë me kodin përkatës sipas legjislacionit në fuqi, për përgatitjen teorike dhe praktike të kandidatëve që kërkojnë të jenë përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke;

c) “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (DPSHTRR) është organi që lëshon Dëshminë e Aftësisë Profesionale (DAP), në përputhje me përcaktimet e pikës 3.a dhe 3.b, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 4.12.2003, të ndryshuar.

KREU II

E DREJTA DHE KUSHTET E VEPRIMTARISË SË SUBJEKTTI JURIDIK

Neni 4

Subjekti juridik do të shërbejë për kryerjen e kurseve të trajnimit teorik dhe praktik, të kandidatëve që dëshirojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale (DAP), si përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke.

Veprimtaria e subjektit juridik është tërësia e funksionimit në zhvillimin e kurseve teorike dhe praktike në të gjitha komponentët bazë që përfshijnë:

1. ambientet për zhvillimin e mësimdhënies të kursit teorik;
2. mjetet për kursin praktik;
3. mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës;

Subjektet juridike, duhet të posedojnë me një nga format e pronësisë, makineri të rënda për punime ndërtimi dhe toke të tipit sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, respektivisht sipas kursit të trajnimit që do të zhvillojnë.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë, subjekti juridik duhet të mbajë dhe plotësojë rregullisht e me vërtetësi këto dokumente:

1. regjistrin e evidentimit të kandidatëve për përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke (amza);
2. regjistrin e zhvillimit të kursit teorik në klasë dhe atij praktik.

Neni 5

Drejtuesit teknikë të subjekteve juridike janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, në funksion të përgatitjes e kualifikimit profesional nëpërmjet kurseve teorike dhe praktike të personelit përdorues të tyre.

Neni 6

Trajnimi në kursin teorik kryhet nga inxhinierë mekanikë, ose specialistë të punësuar pranë subjekteve juridike, sipas përcaktimeve të pikës 5, shkronja a dhe b e nenit 9 të kësaj rregulloreje dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive të plota teorike në funksionimin e këtyre makinerive, për rreziqet në punë dhe masat e sigurimit teknik për evitimin e tyre.

Për realizimin e përgatitjes praktike, subjektet juridike, të ndryshme nga ata ndërtues apo bonifikues, duhet të sigurojnë ambiente të përshtatshme, të miratuara për punime gërmimi, nivelimi apo sistemimi toke ose në mungesë të tyre, të bashkëpunojnë me subjektet ndërtuese, për shfrytëzimin e ambienteve dhe kantierëve të tyre të ndërtimit, me qëllim praktikimin e kandidatëve si dhe kontrollin e aftësive në përdorimin e tyre.

KREU III

KRITERET PËR KLASIFIKIMIN DHE EMËRTIMIN E MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE DHE LËSHIMIT TË DËSHMISË AFTËSISË PROFESIONALE (DAP)

Neni 7

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, makineritë e ndërtimit ndahen në dy grupe si:

1. Makineri të rënda të punimeve të ndërtimit që përfshijnë grupin e makinerive që paraqesin vështirësi të larta teknologjike e teknike në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

2. Makineri të tjera ndërtimi që përfshijnë të gjitha llojet e makinerive të ndërtimit e të prodhimit të materialeve të ndërtimit, të cilat nuk përfshihen në grupin e parë.



Neni 8

1. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator gjërmimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST;

b)- buldozer gjërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibruës, shtruese asfalto-betonë, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj.

manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST.

c)- Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.

2. Për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejedrejtimit.

KREU IV

ORGANIZIMI I TRAJNIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Neni 9

Zhvillimi i kursit teorik

Ambientet e subjektit juridik (klasat), për zhvillimin e mësimit teorik duhet të plotësojnë të gjitha kushtet me këto të dhëna si:

1. Të ketë ambient të mjaftueshëm dhe funksional me kapacitet jo më pak se 10 vende, i kompletuar me tavolina dhe ndenjësë të përshtatshme me hapësira optimale si dhe të ketë vend për mësuesin e kursit teorik.

2. Të ketë ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm, si dhe ambiente hidrosanitare me parametra standarte dhe me ujë të vazhdueshëm.

3. Të ketë pajisje didaktike të ndryshme për demonstrimin e manovrimeve nga përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, ku këto njohuri të jenë fituar gjatë periudhës së kryerjes së kursit teorik si:

a) Tabelë shkrimi, stenda apo makete, pllakata etj, për demonstrimin e manovrimeve nga përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit në kushtet e një kryqëzimi ose rrethrotullimi në rrugë qytetëse, kantiere, ose jo qytetëse.

b) tabela me figura të tipave të ndryshme të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke siç janë përmendur në nenin 8.

c) Subjekti juridik duhet të pajisë klasat e mësimit teorik me mjete audiovizive për të bërë më të kuptueshëm dhe konkret demonstrimin e programit si dhe dy kompjutera për qëllim mësimi të kandidatëve.

4. Koha e mësimdhënies për kursin teorik duhet të jetë 16 orë, të cilat do të zhvillohen në 8 ditë me nga 2 (orë) secila.

5. Kursi teorik do të zhvillohet mbi bazën e programit mësimor pjesë e kësaj rregulloreje dhe do të kryhet:

a) Në të gjitha subjektet që kanë aktivitet të vetëm atë të autoshkollës, nga inxhinierë mekanikë në përputhje me përcaktimet e nenit 121 të ligjit Nr. 8378, dt. 22.7.1998, “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pajisur me dëshminë përkatëse që lëshohet nga DPSHTRr-ja. Vijueshmëria e kursit teorik dhe pjesëmarrja e kandidatëve dokumentohen në Regjistrin e zhvillimit të programit teorik përkatës, njësoj si për kandidatët që kërkojnë të pajisen me një kategori të caktuar leje drejtimi.

b) Në të gjitha subjektet që kanë aktivitet kryesor punimet e ndërtimit dhe tokës si dhe kryejnë aktivitetin e përgatitjes së kandidatëve për manovratorë të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, nga drejtuesit teknikë, inxhinierë mekanikë, të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e përdorimit të këtyre makinerive.



Neni 10

Zhvillimi i kursit praktik

1. Subjektet juridike ose subjektet ndërtuese duhet të posedojnë me një nga format e pronësisë, makineri të ndryshme ndërtimi dhe të punimeve në tokë, që plotësojnë kushtet për kursin praktik të kandidatëve, si përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.

2. Makineritë e rënda, që plotësojnë kriteret sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor me autorizimin përkatës për t'u përdorur si mjete mësimore në zhvillimin e kursit praktik të aplikantëve për përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe të jenë të evidentuara në regjistrin përkatës të drejtorisë rajonale sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja. Këto mjete, të ndryshme nga ato që përdoren për ushtrimin praktik për kategoritë e lejedrejtimit, nuk do kenë shënimin autoshkollë, pasi ushtrimi praktik në këtë rast është i lidhur me pajisjet apo mekanizmat të cilat ato mbartin për realizimin e punimeve të ndërtimit apo edhe të tokës, dhe jo për drejtimin e tyre si mjete rrugore.

3. Çdo subjekt juridik ose subjekt ndërtues, duhet të ketë instruktorin e praktikës, i cili të jetë pajisur me Dëshminë e Aftësisë Profesionale përkatëse dhe me eksperiencë pune jo më të vogël se 5 vjet. Instruktorët e praktikës zhvillojnë sipas programit të miratuar, kurset përkatës dhe vijueshmërinë dhe përgatitjen e kursantëve e dokumentojnë në Regjistrin e zhvillimit të kursit praktik.

4. Përgatitja praktike e kandidatëve, në të gjitha rastet do të bëhet në ambiente të përshtatshme si më poshtë:

a)- fillimisht në fushë, rrugë e mjedise të pa banuara, ku nuk ka lëvizje të dendura për të praktikuar komandat bazë në lëvizjen e makinerive para dhe mbrapa; kthimet në vend dhe në lëvizje; komandimin e lehtë të agregatëve të makinerive pa ngarkesë; pozicionimin e tyre sipas punimeve që do kryejnë.

b)- për të garantuar një lëvizje të sigurt nga ambientet e strehimit në kantieret e punës, kur nuk është i nevojshëm transporti me rimorkjator, do të praktikohet fillimisht lëvizja e tyre në rrugë

jashtë qendrave të banuara, ditën dhe natën; kur do të jetë i nevojshëm transporti me rimorkiator apo me mjete të tjera do të praktikohet ngarkimi i tyre në këto mjete, fiksimi dhe sigurimi dhe zbritja pa avari.

c)- në kantieret e ndërtimit për të praktikuar lëvizjet, pozicionimin dhe përgatitjen e mjetit për të filluar procedurën e punimit përkatës; gërmimet për thellim të sipërfaqes, rievimit, spostimit dhe transportit të dherave, për kanale dhe themele etj.; ngarkimin e mjeteve me mbeturina të ngurta apo inerte; përgatitjen dhe transportin e betoneve nga fabrikat e prodhimit në objektin që ndërtohet etj.

5. Koha e përgatitjes për kursin praktik, për çdo kandidat të jetë 8 (orë), pra 1 (një) orë në ditë, i cili duhet të zhvillohet pas mësimit teorik.

6. Numri maksimal i kandidatëve që lejohen të ushtrohen në një cikël me një mjet (makineri të rënda ndërtimi) dhe një instruktor, për çdo lloj makinerie, nuk duhet të jetë më shumë se 8 veta. Sektori i lejeve të drejtimit në drejtorinë rajonale duhet t'i evidentojë në një regjistër të veçantë.

7. Makineritë e rënda për punime ndërtimi dhe toke, vetëlëvizëse me goma, duhet të jenë me pamje të jashtme të rregullta dhe në gjendje të mirë teknike, të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik dhe të regjistruara me leje qarkullimi nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 11

Për të provuar aftësitë teorike dhe profesionale të manovratorëve të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, që aplikojnë për të marrë Dëshmi Aftësie Profesionale, ngrihet një komision i posaçëm, me inxhinierë mekanikë të DPSHTRr-së.

KREU V
REGJISTRIMI DHE ORGANIZIMI I
TESTIMIT

Neni 12

Regjistrimi i kandidatëve

1. Kandidatët regjistrohen nëpërmjet subjekteve juridike të zgjedhura prej tyre në zyrat përkatëse të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të



Transportit Rrugor, në juridiksion e të cilës kryen aktivitetin subjekti që do të kryejë përgatitjen e tyre.

2. Për t'u regjistruar, për të kryer kursin teorik dhe praktik, për çdo kandidat, autoshkolla e përzgjedhur prej tyre, duhet të dorëzojë në zyrën e regjistrimit të DRSHTRR-së, këto dokumente:

- fotokopje e kartës së identitetit;
- fotokopje e lejes së drejtimit nëse ka;
- raportin mjekësor për të vërtetuar aftësitë e tij fizike në lidhje me makinerinë që do të përdorë;
- 2 fotografi 4.2 x 3.5.

Zyra e regjistrimit të DRSHTRR-së, dokumentacionin e mësipërm e depoziton në N/Dosjen e kandidatit, së bashku me Autorizimin për kryerjen e kursit teorik dhe praktik.

3. Kandidati i cili do regjistrohet duhet të ketë mbushur moshën që i korrespondon pajisjes me lejedrejtimi sipas neneve 114 dhe 115 të Kodit Rrugor.

4. Pas përfundimit të plotë të kursit teorik dhe praktik që ka zhvilluar kandidati pranë një subjekti juridik që plotëson kriteret sipas pikës 1, neni 6, drejtuesi teknik i subjektit juridik përpilon listën përkatëse të kandidatëve që janë të aftë t'i nënshtrohen provimit dhe ja dërgon DPSHTRR-së, e cila njofton subjektet për orën, datën dhe vendin ku do të zhvillohet provimi i radhës.

Neni 13

Zhvillimi i provimit

1. Me urdhër të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm, krijohet komisioni i marrjes në provimin teorik të kandidatëve për përdorues të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, i cili përbëhet nga 3 specialistë, inxhinierë mekanikë të DPSHTRR-së.

2. Marrja në provim e kandidatëve për përdorues të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, bëhet pasi ata të kenë deklaruar se kanë kryer kursin teorik dhe praktik sipas përcaktimeve të nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

Subjektet ndërtues, bonifikues ose autoshkollë, të pajisur me licence për ushtrimin e veprimtarisë, për përgatitjen teorike dhe profesionale të kandidatëve për përdorues të

makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, janë të detyruar që për çdo kandidat të përgatitur prej tyre, të lëshojnë një vërtetim, për aftësimin e plotë të tyre, për përdorimin e makinerive sipas shkronjave a, b dhe c të nenit 8, për të cilën ka kërkuar pajisjen me DAP.

3. Testet e provimit përgatiten nga specialistët e DPSHTRR-së, në përputhje me programin e miratuar nga kjo Drejtori, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

4. Komisioni i provimit i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, merr në dorëzim materialet e parashikuara për funksionimin e rregullt të provimit:

- a) regjistrin e protokollit;
- b) testet e provimit, të miratuara nga drejtori i përgjithshëm;
- c) listat emërore të kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit, të paraqitura, para provimit nga subjektet përkatëse që kanë kryer përgatitjen e tyre së bashku me dosjet përkatëse të kandidatëve dhe pasi verifikon rregullueshmërinë e tyre, fillon seancën përkatëse të provimit.

Pjesëmarrja e kandidatëve në provim kushtëzohet me paraqitjen e dokumentit të identifikimit.

5. Çdo kandidat i nënshtrohet një provimi të detyrueshëm me anë të plotësisimit të një testi i cili përbëhet nga 10 pyetje të paraqitura në tri alternativa të ndryshme, pra gjithsej 30 pyetjeve, të vlerësuara me nga një pikë secila.

6. Për t'u shpallur fitues i provimit, kandidati duhet të japë përgjigje korrekte të paktën për 24 pyetje.

7. Kandidati i vlerësuar fitues në testim, pajiset me Dëshminë e Aftësisë Profesionale.

8 Kandidatët nuk mund të merren në provim pa realizuar programin e plotë teorik dhe praktik, të vërtetuar nga subjekti juridik privat.

9 Komisioni i marrjes në provim në datën e përcaktuar, duhet të marrë në provim të gjithë kandidatët e paraqitur. Numri i seancave përcaktohet nga numri i kandidatëve të paraqitur nga subjektet e licencuara. Koha e provimit (seanca) është 1 (një) orë.

10. Kandidatët kanë të drejtë të paraqiten deri në pesë herë në provim, brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit, i cili është 1 (një) vit, por nga një provim me rezultat negativ në tjetrin, duhet të kalojnë të paktën 15 ditë.



11. Provimi mund të zhvillohet edhe në ambientet e subjekteve private, në se ata kanë të paktën 8 kandidatë për testim. Kur numri i kandidatëve të një subjekti është më i vogël se 8, DPSHTRR, mund të organizojë testimin e tyre duke bashkuar kandidatët e më shumë se një subjekti. Në këtë rast testimi do të kryhet në ambientet e subjektit që ka numrin më të madh të kandidatëve, duke i njoftuar ata paraprakisht. Në varësi të numrit të seancave të mundshme, testimi duhet të fillojë në orën 10^{oo} deri në 16^{oo}.

12. Dokumenti bazë për marrjen në provim të kandidatëve është libri i protokollit, ku hidhen të gjitha rezultatet në ditët e planifikuara nga komisioni i marrjes në provim, i cili harton procesverbalin përfundimtar të firmosur prej tyre.

13. Të dhënat e çdo kandidati të shpallur fitues në provimin përkatës si dhe të dhënat e dëshmisë së fituar prej tij, hidhen në regjistrin kombëtar kompjuterik.

Neni 14

Pajisja me dëshminë e aftësisë profesionale

1. Kandidatët të cilët kryejnë kursin sipas programit të trajnimit teorik dhe praktik, si përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, si dhe kalojnë me sukses provimin sipas nenit 13, përfitojnë Dëshminë e Aftësisë Profesionale, sipas nenit 8, pika 1, si manovratorë të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë.

2. Dëshmia e Aftësisë Profesionale lëshohet në përputhje me modelin e miratuar nga DPSHTRr-ja.

3. Dëshmia e Aftësisë Profesionale është e vlefshme me afat 5 vjeçar, nga data e lëshimit dhe shfrytëzohet vetëm për ato qëllime për të cilat ajo është lëshuar.

4. Çdo korrigjim e bën dëshminë të pavlefshme.

5. Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.

6. N/dosjet e kandidatëve të shpallur fitues, së bashku me dëshmitë e aftësisë profesionale (DAP), sipas përkatësisë u rikthehen drejtorive rajonale ku kandidati ka vendbanimin. Sektori përkatës i DRSHTRR-së, iu shpërndan dëshmitë e aftësisë profesionale mbajtësve të tyre, pasi të

kenë kryer pagesat përkatëse, ndërsa n/dosjet, nëse kandidati është i pajisur me lejedrejtimi, t'i bashkëlidhen dosjes së lejedrejtimit dhe nëse kandidati nuk është i pajisur me lejedrejtimi, të sistemohen në dosar të veçantë po në këtë arshivë.

Neni 15

Rinovimi i DAP-së dhe njëvlershmëria e DAP-eve të lëshuara nga shtetet e huaja

1. Kur mbajtësi i një Dëshmie të Aftësisë Profesionale (DAP) kërkon rinovimin e dëshmisë kur është mbushur afati i vlefshmërisë, duhet të bëjë një kërkesë me shkrim në sektorin përkatës të DRSHTRR-së që ka në juridiksion vendbanimin e tij, të shoqëruar me dëshminë origjinale.

Në rastet kur:

a) Dëshmia e Aftësisë Profesionale është lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve para datës 23.3.2010, ajo do të pranohet të rinovohet nëse është në origjinal dhe në përputhje me praktikat protokollare të kësaj shoqate dorëzuar në DPSHTRR.

b) Dëshmia e Aftësisë Profesionale është lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ndërtimit apo dhe nga çdo institucion tjetër i autorizuar para datës 23.3.2010, ajo do të pranohet të rinovohet vetëm në se i interesuari do të paraqesë në origjinal dëshminë që disponon.

c) Dëshmia e Aftësisë Profesionale është në origjinal dhe pretendohet se është lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve, por nuk figuron në praktikat protokollare të kësaj shoqate të dorëzuar në DPSHTRR, i interesuari duhet të paraqesë një vërtetim zyrtar, nga subjekti apo institucioni që e ka lëshuar, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë, numri i protokollit dhe data e lëshimit të saj si dhe kopje e librezës së punës të legalizuar, ku është shënuar profesioni për të cilin kërkohet shërbimi.

2. Kur mbajtësi i një Dëshmie të Aftësisë Profesionale (DAP) kërkon zëvendësimin për shkak të humbjes së saj, kërkesa duhet të bëhet me shkrim në sektorin përkatës të DRSHTRR-së që ka në juridiksion vendbanimin e tij, me sqarime të hollësishme mbi humbjen e saj, të



shoqëruar nga një deklaratë përgjegjësie për humbjen, si dhe të dorëzojë:

- fotokopje të kartës së identitetit,
- fotokopje të lejes së drejtimit, nëse ka,
- raportin mjekësor për të vërtetuar aftësitë e tij fizike në lidhje me makinerinë që do të përdorë,
- 2 fotografi 4.2 x 3.5.

Në rastet kur:

a) Dëshmia e Aftësisë Profesionale e humbur, është lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve para datës 23.3.2010, do të pranohet të rinovohet nëse është lëshuar në përputhje me praktikat protokollare të kësaj shoqate dorëzuar në DPSHTRR.

b) Dëshmia e Aftësisë Profesionale e humbur pretendohet të jetë lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve, por nuk figuron në praktikat protokollare të kësaj shoqate të dorëzuara në DPSHTRR, i interesuari duhet të paraqesë një vërtetim zyrtar, nga kjo shoqatë, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë numri i protokollit dhe data e lëshimit të saj si dhe kopje e librezës së punës të legalizuar, ku është shënuar profesioni për të cilin kërkohet shërbimi.

c) Dëshmia e Aftësisë Profesionale e humbur, është lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ndërtimit, apo dhe nga çdo institucion tjetër i autorizuar para datës 23.3.2010, do të pranohet të rinovohet nëse i interesuari do të paraqesë një vërtetim zyrtar, nga subjekti apo institucioni që e ka lëshuar, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë, numri i protokollit dhe data e lëshimit të saj ose në pamundësi të vërtetimit, kopjen e librezës së punës të legalizuar, ku është shënuar profesioni për të cilin kërkohet shërbimi.

3. Kur mbajtësi i një Dëshmie të Aftësisë Profesionale (DAP), kërkon zëvendësimin për arsye të dëmtimit të saj, duhet të paraqesë kërkesën me shkrim në sektorin përkatës të DRSHTRR-së që ka në juridiksion vendbanimin e tij, shoqëruar dhe me dëshminë e dëmtuar dhe të dorëzojë:

- fotokopje të kartës së identitetit,
- fotokopje të lejes së drejtimit, nëse ka,
- raportin mjekësor për të vërtetuar aftësitë e tij fizike në lidhje me makinerinë që do të përdorë,
- 2 fotografi 4.2 x 3.5

Në rastet kur:

a) Dëshmia e Aftësisë Profesionale e dëmtuar, e lexueshme ose jo, është e lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve, duhet të pranohet pasi të jetë kontrolluar vërtetësia e saj, në praktikat protokollare të shoqatës të dorëzuara në DPSHTRR. Në rast se nuk figuron në praktikat arkivore të saj, i interesuari duhet të paraqesë dhe një vërtetim zyrtar, nga kjo shoqatë, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë, numri i protokollit dhe data e lëshimit të saj si dhe kopjen e librezës së punës të legalizuar, ku është shënuar profesioni për të cilin kërkohet shërbimi.

b) Dëshmia e Aftësisë Profesionale e dëmtuar, e lexueshme ose jo, është e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ndërtimit, apo dhe çdo institucion tjetër i autorizuar, para datës 23.3.2010, duhet të shoqërohet dhe me një vërtetim zyrtar, nga institucioni që e ka lëshuar, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë ose në mungesë të vërtetimit, kopje e librezës së punës të legalizuar, ku është shënuar profesioni për të cilin kërkohet shërbimi.

4. Rinovimi i dëshmimeve të Aftësisë Profesionale të lëshuara nga DPSHTRR-ja pas datës 23.3.2010, do të bëhet referuar regjistrin të protokollit përkatës.

5. Drejtoritë rajonale, kërkesat për rinovimin apo zëvendësimin e dëshmimeve, së bashku me dokumentacionin sipas pikës 2, të nenit 12, të kësaj rregulloreje, ja përcjellin për kompetencë Drejtorisë që mbulon kualifikimet profesionale në DPSHTRR.

6. Drejtoria që mbulon kualifikimet profesionale në DPSHTRR, shqyrton kërkesat për rinovimin e Dëshmimeve të Aftësisë Profesionale, të paraqitura nga Drejtoritë Rajonale, dhe kur i shikon në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje kryen rinovimet përkatëse.

7. N/Dosjet e kandidatëve të ardhura për rinovim, së bashku me dëshmitë e aftësisë profesionale (DAP), rikthehen në DRSHTRR përkatëse. Dëshmitë iu shpërndahen mbajtësve të tyre, pasi të kenë kryer pagesat përkatëse ndërsa n/dosjet, nëse kandidati është i pajisur me lejedrejtimi, t'i bashkëlidhen dosjes së lejedrejtimit dhe nëse kandidati nuk është i pajisur me lejedrejtimi, të sistemohen në dosar të veçantë po në këtë arshivë.



8. DAP-et e lëshuara nga shtetet e huaja, njihen si të tilla me kushtin që, të jenë të vlefshme dhe të shoqërohen nga një përkthim zyrtar në gjuhën shqipe ku të jetë qartazi e përcaktuar klasa e makinerisë për të cilën janë lëshuar, si dhe të bëhet vetë deklaram mbi autenticitetin e Dëshmisë së Aftësimit Profesional.

KREU VI

DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT DHE RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK

Neni 16

Në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, kërkohet në të njëjtën kohë përcaktimi i klasifikimit sipas tipave të makinerive të rënda të ndërtimit që:

1. Mjetet e ndërtimit sipas nenit 58 të Kodit Rrugor, janë makineri teknologjike vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makineri janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma speciale.

2. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara në aktet nënligjore.

3. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor dhe disiplinimit të tyre, makineritë e ndërtimit dhe punimeve në tokë klasifikohen në:

a)- mjete ndërtimi vetëshkarkuese, ngarkues – transportues, autobetonjere, buldozer, automakineri shpimi, ekskavator me zinxhirë, ekskavator me goma, ekskavator me zinxhirë hidraulik dhe ekskavatorë hidraulikë me zinxhirë për hapje kanalesh.

b)- mjete ndërtimi rrugësh autoskrej për ngarkimi, transportimi, shkarkimi, grejder (autoshatë niveluese), rul-vibrues, automakineri betonshtuese dhe automakineri asfaltuese.

c)- mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve si motopirunët dhe elektropirunët etj.

Neni 17

Për të mundësuar lëvizjen në rrugë dhe për të shmangur aksidentet, mjetet për të cilat bën fjalë neni 8 i kësaj rregulloreje duhet të qarkullojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 18

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ushtron kontroll dhe inspektime mbi veprimtarinë e subjekteve të licencuara, duke iu referuar nenit 121 të Kodit Rrugor. Përbëjnë kontroll veçanërisht:

- aftësia profesionale e personelit trajnues;
- gjendja e makinerive të ndërtimit sipas normave në fuqi;
- plotësimi i pajisjeve didaktike;
- përshtatshmëria e mjediseve;
- kryerja e rregullt e kurseve të trajnimit teorik dhe praktik etj.

Neni 19

Disiplinimi i makinerive të ndërtimit dhe punimeve në tokë, karakterizohet nga lloji i tyre, konstruksioni, mënyra e përdorimit, si dhe qarkullimi me ose pa pajisjet e punës, të njohura nga qendra e miratimit apo homologimit si të zmontueshme, me kusht që për çdo rast të respektohen kufijtë e përmasave dhe ndërmjet peshës ose peshave që rëndojnë mbi aksin ose akset e përparme, si dhe të atyre që rëndojnë mbi aksin ose akset e pasme.

Neni 20

Makineritë e ndërtimit në disa raste quhen mjete zhvendosëse, kur përdoren për transporte të kombinuara apo sipas lëvizjes së tyre në zonat si, në kantiere ndërtimi, rrugë, autostrada, ndërtim digash në hidrocentrale, porte, aeroporte ose vepra të tjera bonifikuese, të caktuara për të lidhur dy ose më shumë nga zonat, edhe kur ato janë ndërprerë nga zonat publike.



Neni 21

Subjektet ndërtimore ua dorëzojnë me procesverbal makineritë, vetëm përdoruesve të pajisur me Dëshmi Aftësi Profesionale të cilët e shfrytëzojnë, mirëmbajnë dhe përgjigjen për dëmet që shkaktohen për faj të tyre. Procesverbali firmoset nga drejtuesit e shoqërisë dhe nga përdoruesi marrës në dorëzim.

Neni 22

Procesverbali i marrjes në dorëzim të makinerisë dhe Dëshmia e Aftësisë Profesionale (DAP), janë dokumente teknike që duhet të mbahen detyrimisht nga përdoruesi gjatë gjithë kohës që shfrytëzon makineritë. Ato paraqiten sa herë që kërkohet nga personat e ngarkuar për kontroll. Ndalohet shfrytëzimi i makinerisë nga përdoruesit pa qenë të pajisur me këto dokumente.

Neni 23

Për mjetet ngritëse, si vinç-kullë, vinç-derik, vinç-stacionar, ashensorë, zmontimi dhe montimi në objektin e ri, do të bëhet me specialistë, nën mbikëqyrjen e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe një inxhinier mekanik i pajisur me licencë, të cilët do të asistojnë dhe do të kontrollojnë të gjitha regjistrimet dhe provat që duhet të plotësojnë këto makineri (prova pa ngarkesë dhe me ngarkesë) për të qenë të gatshme për punë. Në përfundim të provave mbahet një procesverbal ndërmjet drejtuesit teknik të subjektit, specialistëve të montimit, inxhinierit mekanik dhe manovratorit.

Neni 24

Përdoruesi i mjetit çdo ditë para fillimit të punës provon gjendjen teknike të makinerisë duke e venë atë në lëvizje. Nëse konstaton ndonjë mungesë ose defekt, ndalon makinerinë dhe lajmëron personat përgjegjës. Ndalohet fillimi dhe vazhdimi i punës me makineri të defektuara dhe me mungesa.

Neni 25

Subjektet ndërtimore janë të detyruara të japin udhëzime mbi rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat e shfrytëzimit të makinerive që janë në përdorim jo me pak se një herë në tre muaj.

Neni 26

Në rastin kur makineria punon me ndërresa, kontrolli i gjendjes teknike të makinerisë bëhet në praninë e dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim. Marrësi në dorëzim, në qoftë se bindet se makineria është në gjendje të mirë, fillon punën, në të kundërtën lajmëron menjëherë përgjegjësin për gjendjen teknike të saj. Shënimet mbi gjendjen teknike të makinerisë bëhen në librin e dorëzimit të turnit, me të cilin pajiset çdo makineri që punon me ndërresa.

Neni 27

Personeli inxhiniero-teknik, si dhe manovratorët e makinerive në shoqëritë ndërtimore, janë të detyruar që para vënies në shfrytëzim të makinerive dhe pajisjeve të njohin dhe të zbatojnë, rregullat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe sigurimit teknik të tyre, si dhe të kryejnë provat e plota teknike dhe teknologjike.

Neni 28

Subjektet ndërtimore organizojnë punën me makineri në objektet që ndërtojnë sipas një planorganizimi të hartuar e të miratuar prej tyre duke pasur parasysh: kapacitetet teknike, zonat e lëvizjes dhe të manovrimit, thellësitë e gërmimit, këndet e skarpateve, rrugët e kalimit, distancat nga objektet e ndërtuara, shenjat kufizuese për njerëzit etj.

Neni 29

Përdoruesit e makinerive të ndërtimit mbajnë përgjegjësi për gjendjen teknike të makinerisë që përdorin dhe duhet të sigurojnë punë me regjim teknik normal, pa avari dhe me siguri të plotë për jetën e tyre dhe të personave të tjerë që punojnë rreth tyre. Ata nuk zbatojnë asnjë urdhër apo nuk marrin asnjë iniciativë për të punuar në



kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

Neni 30

Për shkeljen e rregullave të administrimit dhe të përdorimit të makinerive, kanë përgjegjësi sipas rastit, disiplinore, materiale ose penale personat fajtorë, si dhe personat që kanë urdhëruar të punohet në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

Neni 31

Në rast se makineria, si rezultat i përdorimit të saj jo të rregullt, shkakton avari që shoqërohen dhe me viktima, njoftohen menjëherë organet ligjzbatuese dhe merren masa për të ruajtur vendin ku ka ndodhur avaria për të mos bërë ndryshime. Përfshihen rastet kur duhen nxjerrë personat e dëmtuar nga avaria për t'u dhënë ndihmën mjekësore, si dhe për të likuiduar vatrën që mund të zmadhojë dëmin.

Neni 32

Përdorimi i makinerive të rënda të ndërtimit pa Dëshminë e Aftësisë Profesionale përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik.

Neni 33

Dispozita të përgjithshme

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Bashkëlidhur është shtojca 1 e përmbajtjes së programit teorik dhe praktik.

3. Modeli i autorizimeve për regjistrimin e aplikantit, vërtetimeve të subjekteve, regjistrat dhe modelet e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale (DAP) miratohen nga DPSHTRR-ja.

SHTOJCA NR. 1

Programi teoriko-praktik për zhvillimin e kursit, që zbatohet nga subjektet juridike, do të organizohet si më poshtë:

Kursi teorik përfshin njohuri, për:

- Makineritë e ndërtimit
- Motorët me djegie të brendshme
- Sistemet e frenimit
- Sistemet e lëvizjes dhe të drejtimit
- Sistemet hidraulike
- Sistemet elektrike dhe elektronike në komandim
- Sistemet e ngritjes (polispaset, kavot, cilindrat, pultet e komandimit, pompat hidraulike, shpërndarësit etj.).

Gjithsej 16 orë kursi teorik

Materiali bazë studimor:

- Ligj nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM nr. 153, datë 7.4.2000, Rregullore në zbatim të Kodit Rrugor.
- VKM nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Kursi praktik përfshin njohuri për:

- Funkcionimin e sistemeve të lëvizjes dhe frenimit.
 - Funkcionimin e sistemeve hidraulike dhe të ngritjes.
 - Manovrat me makineritë e rënda të ndërtimit dhe punimit të tokës.
 - Defektet e mundshme teknike dhe shërbimet përkatëse gjatë punës.
 - Shërbimet periodike (ndërrim vaj motori, vaji hidraulik, filtra etj.).
 - Rregullat e sigurimit teknik.
- Gjithsej 8 orë kursi praktik.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë